

Vendim nr. 145 datë 05.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 05.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 28 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ANILA DAÇI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2795, datë 30.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2474, datë 19.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-3914, datë 20.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Anila Daçi (*kërkesja*) ka ushtruar detyrën e specialistes në sektorin e inspektimit të ushqimit për kafshë dhe operatorëve të biznesit në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë (AKU). Drejtori i përgjithshëm i AKU-së, me urdhrin nr. 528, datë 09.08.2013 (*urdhri nr. 528/2013*), ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 10433/2011*) dhe të urdhrit nr. 382, datë 31.07.2006 “Për miratimin e Rregullores “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar në përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve dhe kafshëve për rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve” (*urdhri nr. 382/2006*).

2. Kërkesja në datën 18.09.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt anulimin e urdhrit nr. 528/2013 të drejtorit të përgjithshëm të AKU-së, dhe detyrimin për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës. Kërkesja ka kërkuar edhe dëmshpërblimin me pagën e 12 muajve punë për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, dëmshpërblimin me pagën e 2 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, dëmshpërblimin me pagën e 2 muajve për mosndjekjen e procedurës ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe dëmshpërblimin me pagën e pushime vjetore për vitin 2013.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 483, datë 21.01.2014, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2795, datë 30.05.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e AKU-së, Tiranë t’i paguajë kërkueses një dëmshpërblim me pagën e 2 (dy) muajve, për shkak të mosrespektimit të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kanë paraqitur ankim kërkuessa, e cila ka kërkuar pranimin e padisë, si dhe AKU-ja, Tiranë që ka kërkuar rrëzimin e padisë. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2474, datë 19.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2795, datë 30.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Kundër vendimit ka ushtruar rekurs kërkesja dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3914, datë 20.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk u referohet asnjë prej shkaqeve ligjore që parashikohen në nenin 58 të

ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

7. Kërkuesja në datën 27.04.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 04.05.2023, pas plotësimit të dokumentacionit.

II

Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t’u dëgjuar, të parashikuar nga neni 33 i Kushtetutës*, pasi gjatë të gjitha seancave gjyqësore të zhvilluara gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ajo nuk është dëgjuar ose pyetur për të sqaruar rrethanat e çështjes. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk është thelluar për të lexuar me saktësi dhe interpretuar nenet e ligjit nr. 10433/2011. Gjithashtu, gjatë gjykimit në atë gjykatë, për shkak të diskriminimit profesional dhe ekonomik, i është shkaktuar gjendje e rëndë emocionale.

8.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, sipas nenit 18 të Kushtetutës*, pasi nuk ka pasur trajtim të barabartë me kolegen e saj, e cila ka qenë pjesë e të njëjtit grup pune dhe është larguar për shkelje të rënda të ligjit, sikurse kërkuesja. Gjyqtarë të ndryshëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që kanë gjykuar çështjet respektive, kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individi, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit

publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

11. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimitimi i kërkueses, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae* Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një tjetër kriter paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuësi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

14. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Rregulli i shterimit të mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (*parimi i subsidiaritetit*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se pavarësisht se kërkesja në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar tre vendimet e dhëna gjatë procesit gjyqësor, në përmbajtjen e tij ka parashtruar pretendime vetëm për procesin e zhvilluar gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

17. Konkretisht, kërkesja ka parashtruar dy pretendime: (i) gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi nuk është dëgjuar ose pyetur për të sqaruar saktësisht rrethanat dhe faktet e çështjes, si dhe nuk është thelluar për të lexuar me saktësi dhe interpretuar ligjin nr. 10433/2011; (ii) gjatë gjykimit të çështjes ajo nuk është trajtuar në kushte të barabarta me kolegen e saj, e cila ishte larguar nga detyra po për shkelje të ligjit, pasi ishin në të njëjtin grup pune, duke u cenuar parimi i barazisë përpara ligjit dhe i mosdiskriminimit.

18. Për pretendimin e parë, për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Kolegji, nga përmbajtja e apelit dhe rekursit konstaton se kërkesja nuk ka parashtruar asnjë pretendim se nuk është dëgjuar gjatë gjykimit, për rrjedhojë, në këtë aspekt, ajo nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

19. Për pretendimin e dytë, për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, Kolegji konstaton se kërkesja e ka parashtruar në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkesi nuk provon në nivel

kushtetues se ka marrë dënimin në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, mban datën 20.12.2022 dhe kërkesja i është drejtuar Gjykatës në datën 27.04.2023. Kërkesja, në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual, ka pretenduar se zyrtarisht vendimi është shpallur në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në fund të muajit janar, pa përcaktuar datën konkrete. Në këto rrethana, i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë për datën konkrete se kur është bërë i disponueshëm vendimi palëve. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2886/1 prot., datë 30.05.2023, ka informuar se vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 30.01.2023 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë në datën 01.02.2023, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji.

22. Kolegji thekson se për sa i përket llojit të pasojave negative të pësura dhe mundësisë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*), kontrolli kushtetues është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit të garantuara në Kushtetutë, të cilat vlerësohen rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe shkeljeve të pretenduara.

23. Në çështjen konkrete, në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkesja, në thelb, ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi gjykatat administrative kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të saj dhe të koleges, pjesë e të njëjtin grup pune, si dhe për caktimin e masës së dëmshpërblimit (*shih faqet 7-8 të rekursit të datës 17.12.2015*). Konkretisht, në rastin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës për kolegen e saj K.K., gjykata e ka konsideruar si të pajustifikuar, duke vendosur një masë dëmshpërblimi me 10 (dhjetë) paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, ndërsa në rastin e kërkeses gjykata e ka konsideruar si të justifikuar zgjidhjen e kontratës së punës dhe kanë vendosur dëmshpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore.

24. Kolegji thekson se nën dritën e parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se barazia përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Kjo presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i

kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit që vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e këtyre gjykatave (*shih vendimin nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kolegji evidenton se vendimi i paraqitur nuk është njësoj për praktikën gjyqësore dhe në kushtet kur kërkesja nuk paraqet ndonjë shkak konkret diskriminimi të saj, ai nuk përbën argument të mjaftueshëm kushtetues se asaj i është cenuar parimi i barazisë para ligjit, në kushtet kur vendimet gjyqësore të dhëna në rastin e kërkesës nuk rezultojnë të jenë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, sipas standardeve kushtetuese. Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të ndryshme të paraqitura prej palëve ndërgjyqëse në secilin rast, ndaj vendimmarrje të lidhura me mosmarrëveshjet e punës të mbështetura, në dukje, në fakte të njëjta, mund të jenë të ndryshme.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar nuk plotëson kriterin për shterimin në substancë të mjeteve juridike efektive që kërkesja ka pasur në dispozicion dhe pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë përpara ligjit është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë çështja nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.